

Komuna e Malishevës

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 30/09/2024

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

PRIMI: 11/1024

Me: 11/1024

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197, nenit 8 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr.04/L-032, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit administrativ nr.05/2021(Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), Udhëzimi administrativ 08/2021 si dhe Rregullores Nr: 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes, së Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorve Profesional, Asistentëve, dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Parauniversitar. Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë shpallë këtë:

K O N K U R S

Viti shkollor -2024/2025

Nr.	Niveli. Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësimit	Numri i pozitave	Orë
1	SHFMU " Ismet Jashari-Kumanova " në Temiqinë	Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e 3	zëvendësimit	1	40
2	SHFMU " 18 Prilli " në Burim	Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e 3	zëvendësimit	1	40
3	SHFMU " Naim Frashëri " në Banjë	Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e 3	zëvendësimit	1	40
4	SHFMU " Xhevdë Krasniqi-Lladroci " Drenoc	Mësimdhënës/e në Shkollë fillore dhe të Mesme të Ulët e lëndës së gjuhës angleze	zëvendësimit	1	20

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e 3

- ✓ Mirëmbajtja e anës teknike- të objektit shkollor për krijimin e kushteve normale të zhvillimit të procesit edukativo arsimor
- ✓ Mirëmbajtja e nxemjes qendrore gjatë sezonit dimërorë dhe krijimi i kushteve normale për ngrohje të objektit shkollor.
- ✓ Bënë sanimin e prishjeve elektronike,
- ✓ Mirëmbanë prishjet që ndollin në sistemin e ujit dhe sanitarisë,
- ✓ Përkujdeset për lëshimin – prej ndezjes së kalldos që nga ora 06 e mengjesit deri në ora 16,
- ✓ Mirëmban pompën dhe kazanin e ujrave atmosferike, gjatë sezonit veror Mmirëmban kopshtin e objektit dhe rrethojën.
- ✓ Bënë kërkesa për furnizim me material, pjesë të nevojshme për mirëmbajtjen e objektit në përgjithësi,
- ✓ Njofton për të gjitha dëmet dhe defektet eventuale në shkollë,
- ✓ Kujdeset për ruajtjen e objektit dhe inventarit të shkollës,
- ✓ Kryen punë të tjera sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës dhe DKAE-së

Kriteret e kualifikimit për Mirmbajtës:

- Shkolla e mesme .

Çdo kandidat (aplikues) duhet të kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje te vertetuar) si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar(merret në Komunë-Qendra për Shërbime me Qytetarë),
- Dëshmi mbi përgatitjen profesionale-kualifikimin, fotokopje e vërtetuar
- Dokumentin e personal(letërnjoftimit ose pasaportën)
- Certifikata që nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar për vepra penale.
- Dëshmi të përvojës së punës .

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për mësime:

- a. Të realizoj plan-programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
- b. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimit;
- c. Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimit aftësive dhe prirjeve individuale të qdo nxënësi;
- d. Të mbikëqyrë dhe të udhëzojë nxënësit në procesin mësimor;
- e. Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënës dhe të kryej me përgjegjësi ekskurzionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve administrative që rregullojnë këtë fushë, dhe sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës;
- f. Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat e përgjithshme për pranimit të zyrtareve publik janë:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Të jetë i/e aftë për të kryer detyrat përkatëse;
- d. Të mos jetë i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- e. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike;
- f. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- g. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve;

Për vendet e theksuar më lartë kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas Udhëzimit administrativ nr.05/2021 (Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), Udhëzimi administrativ 08/2021.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati (aplikacioni merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Ekstrati i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi nga gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose çertifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jshtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)
- Dëshmi shëndetësore (pas përzgjedhjes)
- Çertifikatat për tranimet e kryera.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit nga data, 01.10.2024 deri më 31.10.2024.

Mënyra e aplikimit

Aplikacionet merren dhe dërzohen në Zyrën Pritëse në Komunën e Malishevës. Dokumentet e kompletuar dorëzohen të fotokupjuar, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngusht do të kontaktohen.

Të gjitha dokumentet të dorëzohen në kopje (dokumentet nuk kthehet).

Rezultatet shpallën në web faqe të komunës së Malishevës si dhe në tabelën e shpalljeve të komunës së malishevës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është tridhjetë (30) ditë nga data 01.10.2024 deri më datë,31.10.2024

Drejtoreshë e DAE-së

